



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Lënda: RAPORT I PUNËS SË DUPMM-së

Për periudhën 01.01.2025 - 31.12.2025.

(i formës së shkurtër)

Drejtori: Ali Arifi

Janar, 2026

Ky raport paraqet punën e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUPMM) për periudhën 01 janar 2025 – 31 dhjetor 2025.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në përputhje me kompetencat ligjore, Planin Vjetor të Punës për vitin 2025, si dhe objektivat e përcaktuara në këtë plan, ka qenë e përqendruar në realizimin e detyrave dhe aktiviteteve të parapara, me qëllim përmbushjen e objektivave strategjike dhe operative.

Raporti pasqyron aktivitetet dhe rezultatet e të gjithë sektorëve të DUPMM-së, duke u fokusuar në fushat e planifikuara të punës, të cilat përbëjnë objektivat kryesore të veprimtarisë së Drejtorisë, sipas Planit Vjetor të Punës për vitin 2025.

Raporti është hartuar mbi bazën e të dhënave periodike të përfituara nga sektorët dhe komisionet përkatëse të DUPMM-së, përkatësisht:

Raporti është hartuar mbi bazën e të dhënave periodike të përfituara nga sektorët dhe komisionet përkatëse të DUPMM-së, përkatësisht:

- Sektori për Punë të Përgjithshme Juridike;
- Sektori i Urbanizmit;
- Sektori i Planifikimit;
- Komisionet për trajtimin e ndërtimeve pa leje të Kategorisë I dhe II;
- Komisioni për Leje Mjedisore;
- Komisioni Profesional për Ndryshime të Vogla të Planeve Hapësinore në fuqi në territorin e Komunës së Gjilanit.

Gjatë periudhës raportuese janë pranuar gjithsej **1,260 lëndë**, çka dëshmon për një ngarkesë të konsiderueshme administrative dhe teknike. Nga ky numër, **859 lëndë (rreth 68%)** janë shqyrtuar dhe kanë marrë përgjigje apo vendim përfundimtar brenda vitit raportues, ndërsa **401 lëndë (rreth 32%)** kanë mbetur **në proces shqyrtimi**, kryesisht për shkak të mungesës së dokumentacionit të plotë, kompleksitetit të lëndëve apo afateve procedurale të përcaktuara me legjislacion.

Struktura e lëndëve të pranuar tregon se **83% e tyre kanë qenë lëndë të kompletuara**, ndërsa **17% të pa kompletuara**, gjë që reflekton nevojën për komunikim të vazhdueshëm me palët dhe përmirësim të mëtejshëm të cilësisë së aplikimeve nga qytetarët dhe subjektet përkatëse.

Në tërësi, puna e DUPMM-së gjatë vitit 2025 vlerësohet si profesionale, e qëndrueshme dhe në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm urban, rritjen e transparencës administrative dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Megjithatë, mbetet nevoja për:

- forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike,
- reduktimin e numrit të lëndëve të papërfunduara,
- si dhe avancimin e mëtejshëm të digjitalizimit të procedurave administrative, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe përmbushjen më të shpejtë të kërkesave të qytetarëve dhe subjekteve ekonomike.

Statusi i lëndëve të pranuar për shqyrtim nga Qendra për Shërbim me Qytetar dhe Arkivim


Nr.	Klasifikimi i lëndëve	
1	Lëndë të kompletuara	1,045
2	Lëndë të pa kompletuara	215
Gjithsej		1,260

Lloji i akteve të përpunuara:

Nr.	Emërtimi i aktit	
1	Vendime për lejimin e ndërtimit (leje ndërtimi) - Kategorinë I	70
2	Vendime për lejimin e ndërtimit (leje ndërtimi) - Kategorinë II	36
3	Vendime për përcaktimin - miratimin e kushteve ndërtimore - Kategorinë I	27
4	Vendime për përcaktimin - miratimin e kushteve ndërtimore - Kategorinë II	27
5	Vendime për dhënien e certifikatës së legalizimit - Kategorinë I	197
6	Vendime për dhënien e certifikatës së legalizimit - Kategorinë II	3
7	Vendime për përfshirjen në listën e pritjes - Kategorinë I	24
8	Vendime për përfshirjen në listën e pritjes - Kategorinë II	2
9	Vendime për lejimin e rrënimin (leje rrënimi)	15
10	Vendime për lejimin e riparimit të objekteve	2
11	Vendime për përfundimin e procedurës administrative	123
12	Vendime për dhënien e certifikatës së përdorimit	6

13	Vendime për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale	29
14	Vendime për transferimin e Lejes Mjedisore Komunale	1
15	Vendime për ndryshimin e emrit të poseduesit të lejes ndërtimore	3
16	Vendime për korrigjimin e akteve administrative	16
17	Vendime për anulimin e akteve administrative	4
18	Vendime për pezullimin e procedurës administrative	2
19	Vendime refuzimi	15
20	Vendime për emërtimin e komisioneve	6
21	Njoftime, lidhur me prezantimin e dokumentacionit	205
22	Konfirmime mbi pranimin e shkresave dhe akteve	27
23	Përgjigje në kërkesë	34
24	Përgjigje në kërkesa për qasje në dokumente publike	14
25	Përgjigje në ankesë	1
26	Informata dhe njoftime	60
27	Vërejtje me shkrim	1
28	Pëlqime për ndryshimin e njësive banesore dhe lokaleve afariste	3
29	Pëlqime parimore për vendosjen e paneleve solare	4
30	Pëlqime urbanistiko – teknike për vendosjen e busteve dhe shtatoreve	2
31	Pëlqime urbanistiko – teknike për vendosjen e ekraneve reklamuese	1
32	Pëlqime urbanistike për parcelim	90
33	Ekstrakte/informata nga plani	91
34	Miratim i Ndryshimeve të Vogla të Planeve Hapësinore nga Komisioni Profesional	3
35	Dërgim i ankesave me shkresa përcjellëse në Ministrinë përkatëse (MMPHI)	4
36	Dërgim i lëndëve për trajtim në organin kompetent, për shkak të mungesës së kompetencës	13
37	Autorizime	13
38	Draftpërgjigji në padi	1
39	Kërkesa	38
40	Referenca	6
	Gjithsej	1,219

Gjatë periudhës kohore, **01 janar 2025 – 31 dhjetor 2025**, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ka punuar gjithsej **1,219 akte**, ndërsa në vitin paraprak nga data **01 janar 2024 deri 31 dhjetor 2024**, kjo drejtori ka punuar gjithsej **1,367 akte**. Krahësuar me periudhën raportuese të vitit paraprak, ky organ ka punuar **148 akte më pak se në vitin 2024**, e që shprehur në përqindje është **89.17%**.



Raporti për Sistemin e Adresave

Në Sistemin e Adresave, në programin ARIS, në periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025, numri i rrugëve ka arritur shifrën **1,081 rrugë**, në kuadër të të cilave ka patur rrugë të pa emërtuara dhe të papërfunduara (pa identifikim të hyrjeve të objekteve ose përditësim të të dhënave në sistem), ku në to janë bërë:

1. Identifikimi dhe vektorizimi i rrugëve të reja;
2. Emërtimi i rrugëve ekzistuese dhe të reja, duke u bazuar në vendimet e Komisionit për Emërtimin e Rrugëve;
3. Identifikimi i hyrjeve të reja.

Gjatë muajve mars-prill të vitit 2025, Agjencia Kadastrale e Kosovës, në kuadër të projektit REGIP, ka mbështetur Komunën e Gjilanit për prodhimin dhe instalimin e numrave të hyrjeve. Ku për Komunën e Gjilanit, sipas sistemit ARIS, **janë dedikuar rreth 33,250 numra të hyrjeve**.


Pas vendosjes së të dhënave të rrugëve në sistemin elektronik, përmes daljes në terren dhe konstatimit të gjendjes faktike të tabelave për emërtimin e rrugëve, është përgatitur dosja e materialit për procedimin e prokurimit të projektit: **“Furnizimi dhe vendosja e tabelave për plotësimin e emërtimit të rrugëve”**. Operatori i përzgjedhur, “SINJALIZIMI SH.P.K”, punimet i ka filluar më 28.07.2025 dhe i ka përfunduar përafërsisht pas pesë muajve. Projekti ka përfunduar saktë dhe pa probleme përmbajtësore, sipas gjendjes së prezentuar në vazhdim:

Forma tabelare e sasisë së tabelave të emërtimeve të rrugëve të dedikuara për vendosje sipas Zonave Kadastrale (Z. K.):

Nr.	Zona Kadastrale	Sasia e dedikuar e tabelave
1	Bresalc	25
2	Cërnice	28
3	Dobërçan	32
4	Gadish	2
5	Gjilan	398
6	Kishnapolë	4
7	Kmetoc	17
8	Kravaricë	3
9	Lipovicë	1

10	Livoç i Epërm	18
11	Livoç i Ultë	47
12	Lladovë	3
13	Llashticë	2
14	Malishevë	3
15	Muçibabë	2
16	Përlepticë	32
17	Pidiq	1
18	Ponesh	21
19	Shillovë	23
20	Sllakoc i Epërm	3
21	Sllakoc i Ultë	5
22	Stançiq	4
23	Stublinë	5
24	Velekincë	37
25	Vërbicë e Kmetocit	4
26	Vërbicë e Zhegocit	12
27	Vrapçiq	2
28	Zhegër	2
29	Zhegoc	7
Gjithsej:		743

Forma grafike e sasisë së tabelave të emërtimeve të rrugëve të dedikuara për vendosje sipas Zonave Kadastrale (Z. K.):



Gjatë vitit 2024 është përmbyllur faza e parë e projektit për vendosjen e tabelave me emërtime të rrugëve në komunën e Gjilanit, ku në hartë ngjyra e kuqe dhe e verdhë tregojnë zonat kadastrale ku është implementuar projekti. Kurse, gjatë vitit 2025 është përmbyllur faza e dytë e projektit për vendosjen e tabelave me emërtime të rrugëve në komunën e Gjilanit, ku në hartë ngjyra e gjelbër tregon zonat kadastrale ku është implementuar projekti në tërësi, kurse ngjyra e verdhë tregon zonat kadastrale ku ka pasur nevojë për plotësime.


Tashmë, me këto dy faza të projekteve, i tërë rrjeti i rrugëve në territorin e komunës së Gjilanit është i mbuluar me vendosjen e tabelave të emërtimeve të rrugëve.

Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve

Nr.	Përshkrimi	Realizimi Janar – Dhjetor 2024	Planifikimi 2025	Realizimi Janar – Dhjetor 2025	% e realizimit në periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2025 në raport me periudhën Janar – Dhjetor 2024	% e realizimit Janar – Dhjetor të vitit 2025 në raport me planifikimin për vitin 2025
A	TË HYRAT					
1	Të Hyrat nga Lejet Ndërtimore	1,111,497.26	757,000.00	1,077,346.44	97%	142 %
2	Të Hyrat nga Taksat – Kërkesat	2,349.00	2,000.00	2,589.00	110 %	129%
3	Legalizimet	38,781.11	31,000.00	32,280.88	83 %	104%
4	Të Hyrat nga Lejet Mjedisore	135,682.80	65,000.00	179,580.00	132%	276 %
5	Të Hyrat nga Rrënimet e objekteve	5,567.32	5,000.00	18,974.25	341 %	379 %
	Gjithsej	1,293,877.49	860,000.00	1,310,770.57	101 %	152 %
B	SHPENZIMET					
1	Mallra dhe Shërbime	309,354.00	380,000.00	375,010.71	121%	99 %
2	Komunalitë	7,386.69	9,000.00	7,751.86	105 %	86 %
3	Investimet kapitale	115,813.09	230,000.00	-	-	-
	Gjithsej	432,553.88	619,000.00	381,861.27	88 %	62 %

Aktivitetet e realizuara nga muaji Janar – Dhjetor të vitit 2025 kanë rezultuar me inkasim të vlerës monetare **1,310,770.57 euro**, që është:

16,893.08 euro më shumë se në të njëjtën periudhë raportuese të vitit paraprak që ka qenë **1,293,877.49 euro**, shprehur në përqindje është **101%**. Siç mund të shihet nga të dhënat e prezentuara, vlera e inkasuar në vitin 2025 është më e madhe se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.



Planifikimi i realizimit të të hyrave për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2025 ka qenë **860,000.00** euro, janë realizuar **1,310,770.57** euro, që është për **450,770.57** euro më shumë se sa që janë planifikuar, shprehur në përqindje është **152%**.

